

**STATUTI DHE AKT THEMELIMI I SHOQËRISË  
“INTEGO SERVICES” SH.P.K.**

**(Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar)**

Në bazë të ligjit 9901, datë 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare”, dhe, ligjit nr.9723. date 3.5.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit” une i nënshkruari shpall si më poshtë vijon:

**Neni 1  
FORMIMI I SHOQËRISË**

Sot ne daten 02.04.2024 formohet shoqëria e quajtur **“INTEGO SERVICES” SH.P.K.** (Qe ketu e me poshte referuar si “Shoqeria”, e cila themelohet nga Ortaku si me poshte:

**Z.Dritan GUCAJ**, shtetas shqiptar, i biri i Agim, lindur me 26.12.1979 ne Gjirokaster, banues ne adresen: Rr: “Musa Maci”, Pall. Renis, Ap.12, Tirane, i pajisur me karten e identitetit Nr.038365561 , madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar dhe

**Neni 2  
QENDRA E SHOQËRISË**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresen: **Rr: “Musa Maci”, Pall. Renis, Ap.12, Tirane, Shqiperi.**

Shoqeria ka te drejte te hape dege apo filiale, zyra perfaqesimi, ne te gjithe vendin gjate aktivitetit te saj, brenda ose jashte territorit te vendit.

**Neni 3  
KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË EKONOMIKE**



Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë do të jetë pa afat, duke filluar që prej datës së regjistrimit të saj në Qendren Kombetare të Bisnesit (QKB).

Shoqëria mund të perfundojë, të vihet në likuidim përpara këtij afati të aktivitetit të saj me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

#### **Neni 4**

### **OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është si më poshtë:

1. Inxhinierim dhe programim të sistemeve software, migrime të sistemeve, auditime të sistemeve informatike, testime të sigurisë informatike.

2. Për këto qëllime, shoqëria mund të blejë, të hyjë në marrëdhënie leasing dhe të marrë apo të japë me qira asetë, mund të kryejë, përveç aktivitetëve tregtarë edhe aktivitetë industriale.

3. Për kryerjen e aktivitetit të saj, Shoqëria mund të kryejë çdo operacion tregtar, operacione që lidhen me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, financiare dhe kreditore si edhe të blejë apo shesë apo të marrë apo japë me qira pasuri, si edhe të ketë interesa apo pjesëmarrje në shoqëri, ente, konsorciume, të themeluara apo në themelimin e siper, që kanë një objekt të ngjashëm apo funksional në arritjen e qëllimeve të Shoqërisë, si dhe të ofrojnë garanci, garanci bankare, të marrë hua dhe të ofrojnë garanci, pasurore apo personale, në favor të të tjerëve. Me në përgjithësi, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të saj.

#### **Neni 5**

### **EMRI DHE SELIA E SHOQËRISË**

Kjo shoqëri është person Juridik Privat me emërtimin e saj **INTEGO SERVICES SH.P.K.** Shoqëria mund të ndryshojë emërtimin e saj, vendqëndrimin, objektin e aktivitetit, të shtojë ortakë, të rrisë kapitalin sipas vendimeve të Ortakut .

#### **Neni 6**

### **KAPITALI I SHOQËRISË**



Kapitali fillestar i shoqerise është 100.000 (njqind mije) leke i perbere nga 1 kuote me vlere 100.000(njqind mije) leke, zoteruese 100% te kapitalit te shoqerise.

Kapitali zotërohet 100% nga ortaku si me poshte :

**Z.Dritan GUCAJ**, shtetas shqiptar, i biri i Agim, lindur me 26.12.1979 ne Gjirokaster, banues ne adresen: Rr: “Musa Maci”, Pall. Renis, Ap.12, Tirane, i pajisur me karten e identitetit Nr.038365561, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar i cili zoteron 100 % te kapitalit fillestar

Ortaku mund te vendose te rrisi kapitalin e shoqerise ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi dhe me vendim te Ortakut. Detyrimet e ortakut kundrejt shoqerise do te mbulohen vetem me pjesen e kapitalit te paguar prej tij. Ortaku nuk do te kete asnje pergjegjesi tjeter per detyrime te tjera te shoqerise.

Shoqeria nuk pergjigjet per detyrime te marra per qellime qe nuk perputhen me ato te paracaktuara nga ky Statut, si edhe per detyrime te marra nga Ortaku ne emrin e tij personal.

#### **Neni 7**

### **REGJISTRIMI I SHOQERISE**

Shoqëria tregtare deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave që përmban ky Statut si dhe të legjislacionit shqiptar në fuqi. Ajo konsiderohet e krijuar në datën e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Bisnesit ( QKB) sipas nenit 43 te ligjit 9723 date 3.5.2007.

#### **Neni 8**

### **KALIMI I KUOTAVE DHE E DREJTA E PARABLERJES**

Kuotat e kapitalit te shoqerise si dhe te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo te kalohen nepermjet :

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b) shitblerjes se kuotave



- c) trashegimise
- d) dhurimit
- e) cdo menyre tjeter te parashikuar ne ligj.

Personi qe kalon kuoten dhe ai qe fiton ate pergjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes nga casti i kalimit te kuotave deri ne castin e regjistrimit te kalimit.

- Pjeset e kapitalit mund t'u transferohen te treteve teresisht ose pjeserisht, vetem me vendim te Ortakeve te shoqerise.

### **Neni 9**

Emertimi i shoqerise tregtare, kapitali themeltar, emri i administratorit, duhet te jete te permendura ne te gjitha aktet e nxjerra nga kjo shoqeri dhe qe ju drejtohen te treteve. Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme dhe me permbajtjen perreth saj.

### **Neni 10**

Shoqeria vepron nen regjimin e prones private dhe merr persiper vete te drejtat dhe detyrimet kontraktore

Organet e shoqerise jane:

- 1- Asambleja e Ortakeve te Shoqerise
- 2- Administratori/et

### **Neni 11**

#### **KOMPETENCAT E ORTAKUT**

Per menyren e drejtimit dhe ushtrimit te aktivitetit te shoqerise, Ortaket shprehen me vendime per gjithshka qe eshte ne kompetencat e tyre te pershkruara si me poshte:



- Kane te drejte te bejne ndryshime ne statut.
- Percaktojne politikat tregetare te shoqerise
- Kane të drejtë të miratojnë bilancin e shoqerise dhe te bejne ndarjen e fitimit.
- Ata emerojne ose shkarkojne administratoret, likujduesit ekspertet kontabel te autorizuar.
- Mbikeqyrin zbatimin e politikave tregetare nga administratoret, perfshire pregatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise
- Miratimin e pasqyrave vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise.
- Miratojne zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit.
- Percaktojne shperblimin per administratorin, ekspertet, revizoret kontabel.
- Miratojne pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- Perfaqesojne shoqerine ne gjykate dhe kryejne procedimet e tjera ndaj administratoreve.
- Kryejne riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
- Miratojne rregullat procedurale te mbledhjeve te asamblese.
- Miratojne lidhjen e kontratave per dhenie dhe marrje te drejtash ose ekskluzivitet per tregtimin dhe prodhimin e mallrave te shoqerise si dhe kontrata ne lidhje me organet shteterore per pjesmarrjen ne tender, ankande ose aktivite te tjera te rendesishme.
- Realizojne blerje, shitje si dhe tjetersim te pasurive te palujtshme te shoqerise etj.

## **Neni 12**

### **VENDIMET E ASAMBLESE**

Marrja e vendimeve te Ortakut regjistruhen ne regjistrin e vendimeve te Ortakeve , mbajtja e procesverbaleve dhe te gjitha dokumentat e tjera qe kane te bejne me te duhet te behen sipas legjislacionit ne fuqi per kete qellim. Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshem .

## **Neni 13**

### **THIRRJA E ASAMBLESE**



Asambleja e pergjithshme thirret sa here qe shte e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoqerise. Mbledhja e zakonshme e asamblese se pergjithshme thirret te pakten nje here ne vit.

Asambleja e pergjithshme thirret nga Adminsitratoret ose nga ortaket te cilet perfaqesojne te pakten 5 % te totalit te votave ne Asablene e Pergjithshme te Shoqerise Asambleja e Pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose nepermjet postes elektronike 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese. Njoftimi ne te dyja formate e mesiperme duhet te permbaje vendin, daten ,oren e mbledhjes dhe rendin e dites.

#### **Neni 14**

#### **PJESEMARRJA NE VENDIME**

Cdo ortak, ne rastet kur shoqeria do te kete me shume se nje ortak, ka te drejte te marre pjese ne vendime si dhe disponon nje numer votash te barabarte me pjeset e kapitalit themeltar qe Ai/ajo zoteron.

Ne rastin e marrjes se vendimeve qe kerkojne nje shumice te zakonshme, Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30% te kuotave.

Ne rastin kur asambleja duhet te vendose per ceshtje qe kerkojne shumice te kualifikuar si per shembull ndryshime ne statut, zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit te regjistruar, shperndarja e fitimeve, riorganizimi dhe shperndarja e shoqerise, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 50% te kuotave, dhe votojne pro tre te katertat e votave te ortakeve pjesemarrës personalisht, ose qe votojne me shkrese apo me mjete elektronike

#### **Neni 15**

#### **ADMINISTRIMI**

Shoqeria administrohet nga nje administrator te cilet caktohen ne statutin e shoqerise dhe me pas nga Asambleja e Ortakeve. Administratori/et qendrojne ne detyre per nje periudhe



jo me te gjate se 5 vjet me te drejte riperteritje kohore dhe ne rast se gjate kesaj periudhe shfaqen probleme paaftesie nga ana e tyre, Asambleja e Ortakeve vendos shkarkimin e tyre per shkaqe te arsyeshme.

Administratori/et detyrohen te kryejn te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregetare te shoqerise duke zbatuar politikat tregetare te vendosura nga asambleja e pergjithshme.

Ato kujdesen per mbajtjen sakte dhe te rregullt te dokumenteve, dhe te librave kontabel te shoqerise.

Ato pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor te shoqerise, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise, dhe se bashku me me propozimet per shpernarjen e fitimeve i paraqesin keto dokumente para asamblese se pergjithshme per miratim.

Ato kane te gjitha kompetencat per te vepruar me tretet ne emer te shoqerise dhe ne interes te saj ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji dhe Statuti i shoqerise u'a jep shprehimisht Ortakeve te Shoqerise.

Administratori/et kane te drejte te nenshkruajne per kapitalin e shoqerise, kontrata te ndryshme, per furnizime publike private, cdo lloj operacioni bankar, te veproje me cdo lloj instituti bankar publik e privat, te ndermarre veprime gjyqesore, transaksione te ndryshme, etj, tij. Administratori/et mund te japin prokura ne kufijte qe i lejon Asambleja e Ortakeve per kategori te caktuara veprimesh.

Te gjitha veprimet e tjera duke perfshire pagesa dhe detyrime per tu paguar ose veprime me insitucionet bankare ku perfshihen transferta bankare dhe terheqje parash qe do te ndermerren nga Administratori/et per llogari te shoqerise, eshte e nevojshme dhe e detyrueshme nenshkrimi i Administratori/eve se bashku me vulen e shoqerise, ne menyre qe keto veprime te jene te detyrueshme per shoqerine.

Administrator i shoqerise eshte **Z.Dritan GUCAJ**, shtetas shqiptar, i biri i Agim, lindur me 26.12.1979 ne Gjirokaster, banues ne adresen: Rr: "Musa Maci", Pall. Renis, Ap.12, Tirane, i pajisur me karten e identitetit Nr.038365561, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar. Ai do ta ushtroje kete detyre per nje periudhe 5 vjecare.

**Neni 16**  
**MARREDHENIET E PUNES**



Mardheniet e punes rregullohen nepermjet kontrates se punes dhe legjislacionit te punes ne fuqi. Shoqeria merr persiper te respektoje rregullat ne fuqi te punesimit dhe te punesuarit jane te detyruar qe te respektojne Statutin e kesaj shoqerie dhe rregullat e brendeshme te saj. Te punesuarit duhet te pergjigjen per demet qe i shkaktojne kesaj shoqerie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

#### **Neni 17**

### **KONFIDENCIALITETI, RUAJTJA E SEKRETIT**

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet te behet publike permbajtja e tyre per te tretet e te gjitha akteve dhe dokumentave qe jane percaktuar si te tilla nga administratori i shoqerise.

#### **Neni 18**

### **EKSPERTET OSE REVIZORET KONTABEL**

Kontrolli mbi veprimtarine e shoqerise si dhe gjithe aktivitetin e shoqerise i besohet nje eksperti ose revizori kontabel. Ky ekspert do te qendroje ne detyre per aq sa percaktohet me ligj dhe mund te rizgjidhet. Ortaket caktojne dhe shperblimin perkates kur nuk ka norma te vecanta ligjore.

#### **Neni 19**

### **VITI FINANCIAR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE**

Viti financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit. Administratori/et marrin masat lidhur me perlllogaritjen e rezultateve ekonomike te fitimeve apo humbjeve dhe inventarizimin. Pas analizimit te ceshtjeve te mesiperme si dhe shlyerjen e detyrimeve, te ardhurat e tjera do ti kalojne ortakut te shoqerise.

#### **Neni 20**





## **SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE**

Ne rast se shoqeria shperndahet per cdo lloj arsye Ortaket percaktojne menyren e likuidimit, emerojne nje ose me teper likuidator dhe pergatitin te gjitha dokumentet e nevojshme per c' regjistrimin e saj nga Qendra Kombetare e Regjistrimit.

### **NENI 21**

#### **ZGJIDHJA E MOSMARRVESHJEVE**

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin me interpretimin dhe/ose zbatimin e ketij Statuti do te zgjidhen me mirkuptim dhe do te diskutohen ne menyre te drejperdrejte midis paleve te interesuar.

Ne rast se nuk do te arrihet nje zgjidhje me mirkuptim te mosmarrveshjes, ajo do ti besohet Gjykates se Rrethit Tirane.

### **Neni 22**

#### **DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

Persa eshte shprehur ne kete statut i referohemi ligjit 9901, date 14.04.2008 "Per tregetaret dhe shoqerite tregtare" dhe ligjit Nr.9723, date 3.5.2007 I Ndryshuar "Per Regjistrimin e Biznesit" . Cdo ndryshim behet ne perputhje me kete Statut dhe nuk prek personalitetin juridik te kesaj shoqerie.

Statuti eshte hartuar ne 4 kopje origjinale ne gjuhen shqipe.

## **ORTAKET E SHOQERISE "INTEGO SERVICES" SH.P.K**

**Z.DRITAN GUCAJ**

